

3
P. Kadriu
6-koje
24-06-15
1/2

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

C.nr.270/2015

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu

ne qeshtjen juridike te paditesit, nga Mitrovica e Veriut te cilin e

perfaqson Av. nga Mitrovica sipas autorizimit me shkrim, kunder te

paditesit, nga Mitrovica e Veriut Rr,

baza e kontestit; lirimin e baneses, vlera e lendes se kontestit; 800,00 Euro, pas

mbajtjes se shqyrtimit me dt. 18.06.2015 4. jep.,

A K T G J Y K I M

I- APROVOHET kerkespadia e paditesit nga Mitrovica dhe **DETYROHET** paditura; nga Mitrovica qe te shperngulet nga banesen nr 21 e cila gjendet ne Mitrovicen Rr dhe kete banes ta liroi nga njerzit dhe sendet dhe dorzoi ne posedim paditesit, ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi nen kercnimin e permbarimit te dhunshem..

II- Secila pale i bart shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesi ka parashtruar padi kunder te paditurit per lirimin e baneses duke theksuar se paditesi te emes se te paditures per shkaqe humane perkohsisht I ka leshuar ne shfrytzim bnesen lendore nga se e njejta ka mbetur pa banes nga se per shkaqe te njohura nga pjesa Jugore ka kaluar ne pjesen Veriore te Mitrovices.

Megjenesse tani e ndjera e ish nga Mitrovica ka refuzuar ta liron banesen lendore, par qka paditesi ka parashtruar kerkes per lirimin e saje. Pase vdekjes se njejtës kete banes ka vazhduar ta shfrytzoi vajz e saj tani e paditura, pa asnje baze juridike.

Paditesi drejtperdrejt I eshte drejtuar disa her te paditures qe e njejta ta liroi dhe kthej kete banes paditesit por e njajta refuzon,

Ne fjalenperfundimtare I propozon gjykates qe padin dhe kerkespadin ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzime t e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata seancën e shqyrtimit e mbajti në mungesë të paditues conform nen.423.4 të LPK.

Gjykata në seance të shqyrtimit zhvilloi provat e propozuara dhe të nevojshme dhe pasë administrimit dhe vlersimit të të njëjtave në kuptim të nen. 8 të LPK, erdhi në përfundim se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në procedurë të provave lexoi; Kontraten mbi blerjen e banesës Vr. II nr. dt. 14.12.1993. dhe konstatoi këto gjendje faktike.

Nga kontrata e sipërcekur konstatohet se paditesi është pronar i banesë së sipërcekur tani lëndore.

Nga padia dhe deklarata e të autorizuarit të paditesit rrjedhë se këto banesë e shfrytzojnë e paditura pa kurrfarë baze juridike.

Në një gjendje të kësaj faktike gjykata kërkespudin e paditesit e aprovoi si të bazuar, conform nen 93 të Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore, Ligji Nr. 03/l-154., ku është përcaktuar se; Pronari mundë të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi.

Duke bërë interpretimin e kësaj dispozite ligjore lidhur me mbrojtjen e pronësive jep të kuptohet se pronari duhet të provoi se në sendin të cilin e kërkon të kthehet ka të drejtën e pronësive, si dhe që sendi gjendet në pushtetin faktik të paditurit.

Nga të cekurat rrjedhë se kur kemi të bëjmë me sendet e palujtshme, atëherë shumë me lehtë argumentohet e drejta e pronësive. qka në rastin konkret nga Kontrata mbi blerjen e banesës së sipërcekur vërtetohet se paditesi është pronar i kësaj banesë tani lëndore.

Në një gjendje të kësaj faktike gjykata konstatoi se; pronar i kësaj banesë është paditesi dhe se kjo banesë tani gjendet në pushtetin faktik të të paditues e cila këto banesë e mbajnë pa baze ligjore, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore bazohet në baze të nen.450 të LPK.

Nga si u tha më lart u vendosën në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,

C.nr. 270/2015 dt. 18.06.2015

Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE, Kunder këtij aktgjykimi, mundë të ushtrohet ankese në afat prej 15, ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës e nëpërmjet të kësaj gjykate/

PRANUAR NGA PËRKTHYESIT
ME DT. 21.07.15